



Në mbështetje të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në pajtim me Rregulloren nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall konkurs të jashtëm për pozitën:

**ZYRTAR DHE PERSON KONTAKTUES PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE
(1 Pozitë)**

Numri i Referencës:	20 /2019
Lloji i Pozitës:	Karrierës
Orari:	I plotë
Kohëzgjatja:	Pa afat
Grada - Hapi:	5-8
Njësia:	Njësia për Marrëdhënie me Publikun
Vendi i Punës:	Zyra Qendrore
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë :	Kryesuesi i Njesisë së Marrëdhënie me Publikun

QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I POZITËS

Zyrtari dhe Personi Kontaktues për Qasje në Dokumente Publike luan një rol kyç dhe funksional në promovimin e imazhit të gjithëmbarshëm të punës së AKP-së në Kosovë dhe më gjerë në sensin më pozitiv të mundshëm. Në këtë drejtim, Zyrtari dhe Personi Kontaktues për Qasje në Dokumente Publike është pika referuese sa i përket procedurave të qasjes në dokumentet zyrtare në AKP.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Është përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në Dokumente Publike në harmoni me rregulloren e AKP-së për qasje në dokumentet zyrtare dhe klasifikimin e informacioneve;
- Është përgjegjës për mbajtjen e evidencës së saktë për numrin e kërkesave për qasje në dokumente si dhe për numrin e lejuar apo refuzuar të këtyre kërkesave;
- Përgatit raporte të rregullta dhe këto raporte ia dërgojnë njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, e cila përgatit raportin gjithëpërfshirëse të institucioneve publike, për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike;
- Është pikë referuese për koordinimin dhe ofrimin e këshillave (sipas nevojës) ndaj menaxhmentit të AKP-së sa i përket procedurave të qasjes në Dokumentet Publike sipas Ligjit Nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike;
- Përgjegjës për monitorimin e Mediave të shkruara dhe atyre elektronike;
- Punon ngushtë me ekipin e Marketingut të Agjencisë me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së proceseve gjegjëse;
- Përgjegjës për çështjet administrative në Njësinë për Marrëdhënie me Publikun;
- Detyra dhe Përgjegjësi tjera sipas kërkesës së Kryesuesit të Njesisë.

PËRGADITJET PROFESIONALE / KUALIFIKIMET

- Diplomë Universitare në fushën e Komunikimit , Fushën Juridike, Marrëdhënive me Publikun, Gazetarisë, Administrim Biznesi, Marketing apo fusha relevante me Përshkrimin e Punës së Pozitës;



- Së paku tre (3) vite përvojë të larmishme dhe me përgjegjësi progresive në fushën e Marrëdhënieve me Publikun;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
 - Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
 - Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve të pakos MS;
 - Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ ose serbe në të folur dhe shkruar. Gjuha angleze e preferuar;
 - Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor;

Formularin për aplikim mund ta gjeni në:

www.pak-ks.org

Për aplikim, të gjithë kandidatët duhet t'i bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

Formularin e plotësuar dhe të firmosur;
Letrën përcjellëse/motivuese;
Dëshmi mbi përgatitjen profesionale;
Dëshmi mbi përvojën e punës;
Dy letër rekomandime;
Dokumentin e identifikimit;
Certifikatën që nuk jeni nën hetime.

Formularin për aplikim së bashku me dokumentet përcjellëse i dërgoni në adresën elektronike:

rekrutimi@pak-ks.org

Titulli i e-mailit tuaj duhet të përmbajë pozitën për të cilën ju aplikoni.

Data e fundit për aplikim është: 9 KORRIK 2019 ora 16:00

Dokumentet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar do të refuzohet.

“Agjencia Kosovare e Privatizimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komuniteti jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Ne i falënderojmë të gjithë kandidatët për aplikim, por vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO